



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË



V E N D I M
Nr. 18 datë 28.03. 2022

“Për dhënien në përdorim me afat 9 vjecar sipërfaqen pyjore prej 4.4 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj), dhe bën pjesë në ngastrat nr.6 dhe 17 në ekonominë pyjore Karmë.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, *me shumicë të cilësuar votash.*

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes në total **4.4 ha** për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj), bën pjesë në **ngastrat nr.6 me sipërfaqe 3.6 ha dhe 17 me sipërfaqe 0.8 ha në ekonominë pyjore Karmë, me afat 9 (nente) vjeçar.**

2. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura per Bashkine të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.

3. Vlëra e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

4. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija



Miratuar me 20 vota
Vota Pro 20
Vota Kunder -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 04.04 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
Sektori i Menazhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 09 prot.

Vau Dejës, më 28.01.2022

RELACION

Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet “, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , **neni 54 pika el neni 18**, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 7.

Siperfaqja e marrë në studim do të dale në ankand nëpërmjet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit ne fuqi.

Siperfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 4.4 ha.

Në funksion të siperfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për

percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja 2 pika 5/3 dhe pika 5/6, si me poshtë.

| 5. Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.) | | | | |
|--|------------------------------|---|----------|---------------|
| Nr. | Përdorimi i territorit | Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit | | |
| | | 1 vit | 2-5 vjet | 6-10 vjet |
| 1 | Pyll trungishte | 180 000 | 120 750 | 100 000 |
| 2 | Pyll cungishte | 126 000 | 90 000 | 75 000 |
| 3 | Pyll shkurre | 126 000 | 90 000 | 75 000 |
| 4 | Kullota | 126 000 | 90 000 | 75 000 |
| 5 | Tokë me bimësi pyjore, djerr | 90 000 | 52 000 | 45 000 |
| 6 | Inproduktive | 90 000 | 52 000 | 45 000 |

Vlera totale e pagesës/vit është 306 000 (tre qind e gjashtë mijë) lekë.

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të sipërfaqes prej 4.4 ha .

Bashkëlidhur po ju dergojmë.

1.Dokumentacionin e plote dhe hartën e ekonomisë pyjore.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Specialistet

Ing.Mark Suli



Ing.Esmeraldo Harapi



Ing.Zeqir Ujka



Miratoi

Drejtori

Rrok Etoni



RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS

“PËR QËLLIME PUSHIMI, ARGËTIMI, SHENDETSORE, SHOQERORE DHE PËR VËPRIMTARI TURISTIKE ,KAMPINGJE (KËNDE LOJRASH, MJEDISE SPORTIVE, SHLODHËSË ETJ)”

Bazuar në Urdhërin **nr.5, datë 12.01.2022** të Kryetarit të Bashkise për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”

Grupi i punës i përbërë nga z.Zeqir Ujka ,Pergjegjes i sektorit te pyjeve z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve ,z.Esmeraldo Harapi specialist kadastrë nga data **27.01.2022** deri në datën **28.01.2021** ,realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullosore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore **4.4 ha** “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”.

Mbështetur në të dhënat e rregjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive, rezulton që sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **4.4 ha** për qëllime pushimi argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj” dhe bën pjese në **ngastrat nr.6 me sipërfaqe 3.6 ha dhe 17 me sipërfaqe 0.8 ha** në ekonomine pyjore **Karme**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga “Kujtim Pjetri jepen në përdorim për një afat **9 prej vjet** një sipërfaqe prej **4.4 ha** për qëllime

pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)

Procedurat që ndiqen për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Përrregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor". Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" pika nr 2 gërma (a) dhe 7.

Sipërfaqja e marre në studim do të dale në ankand nëpërmjet procedurës së Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkise nxjerr urdherin për përgatitjen e dokumentave të ankandit nëpërmjet procedurës së konkurimit publik

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullor bazohen në VKM-venë nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" lidhja 2 pika 5/3 dhe 5/6, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. **Shuma në lekë/vit konsiston në:**

1. Vlerën e përdorimit lekë/ha/vit

- a) Ngastra nr. 6 ,shkurre prej 3.6 ha x 75 000 lekë = **270 000** lekë
- b) Ngastra nr. 17 ,Shkëmbore (inproduktive) prej 0.8 ha x 45 000 lekë = **36 000** lekë

Në total 306 000 (tre qind e gjashtë mijë) lekë

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing. Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



Ing. Esmeraldo Harapi



KRYETARI

MARK BABANI



Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR

(sipas regjistrit kadastral)

Për qëllime shoqërore, pushime , argëtimi, etj
Formulari nr.1

| ID. | Ekonomia Pyjore | Parcela | Sip.Tot. ha | Perberja grumbullit | Funksion i | Forma Qeverisjes | Mosha | K.D | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | Fuqia lendore | | |
|------------------|--------------------|---------|----------------|----------------------------|---------------|---------------------|----------|----------|------------------------------|--------------|-----------|--------------|---------------|-----------|-------------|
| | | | | | | | | | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Kat et | Per ha | Total |
| SH34 00 006 | Karmë | 6 | 79.66 | Shkozë | prodhues | shkurre | 40 | 0.8 | 4 | 5 | 0 | 0 | N | 52 | 4207 |
| SH34 00 017 | Karmë | 17 | 3.56 | Shkemoreshi nproductive | shkembore | shkembore | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjithsejt | | | 83.22 | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 52 | 4207 |

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR

(sipas verifikimit ne terren)

Për qëllime shoqërore, pushime , argëtimi, etj
Formulari 2

| ID. | Ekonomia | Parcela | Sip.Tot. | Perberja grumbullit | Funksion | Forma Qeverisjes | Mosha | K.D | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | Fuqia lendore | | |
|------------------|----------|---------|--------------|------------------------|-----------|---------------------|-------|-----|------------------------------|--------------|-----------|--------------|---------------|-----------|-------------|
| | | | | | | | | | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Kat | Per ha | Total |
| SH34 00 006 | Karmë | 6 | 79.66 | Shkozë | prodhues | shkurre | 40 | 0.8 | 5 | 6 | 0 | 0 | N | 62 | 4950 |
| SH34 00 017 | Karmë | 17 | 3.56 | nproductive | shkembore | shkembore | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjithsejt | | | 83.22 | | | | | | | | | | | 62 | 4950 |

PLOTESOI:

Ing. Mark Suli



Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo harapi



Bashkia Vau Dejës

TABELA PERMBLEDHESE E VLERSIMIT FINANCIAR
Për qëllime shoqërore, pushime, argëtimi, etj

Formulari nr.4

| Perdorimi I territorit | Sip ha | Bashkia | Volumi ne m ³ sipas asortimenteve | Sasia | Vlera Leke /m ³ | Shuma I | Gjatesia e perdorimit rruge ne km | Tarifa dhenje ne perdorim lek/ha/vit | | | Shuma II | Totali I+II |
|--------------------------|------------|---------|--|-------|----------------------------|----------|-----------------------------------|--------------------------------------|--------|--------|----------|----------------|
| | | | | | | | | 1 | 2.-5 | 6.-10 | | |
| 0 | 1 | 2 | 3 | | 4 | 5 | 6 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| Pyll shkurre | 3.6 | V.Dejës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 126 000 | 90 000 | 75 000 | 270 000 | 270 000 |
| Shkembore(in produktive) | 0.8 | V.Dejës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 90 000 | 52 000 | 45 000 | 36 000 | 36 000 |
| Gjithsejt | 4.4 | | | | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 306 000 |

LISTA E NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM
Per qellime shoqerore, pushime, argetimi.

Formulari 5

| Nr. | ID Prones | Ekonomia Pyjore/kullosore | Ng/neng,n r. | Siperfaqie qe hiqet nga fondi pyjor/kullos or | Siperfaqia Gjatesia ne perdorim km | | | |
|--------------|-------------|---------------------------|--------------|---|---|----------|-------|-----------------|
| | | | | | Siperfaqie qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kulloso | Rruge km | Linje | Tubacion/ kanal |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 1 | Sh34 00 6 | karmë | 6 | 0 | 3.6 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | SH34 00 017 | Karmë | 17 | | 0.8 | | | |
| Shuma | | | | | 4.4 | | | |

PLOTESOI:

Ing. Mark Suli




Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeralda harapi



Ekonomia Pjore Karmë SH 1:10 000



[Handwritten signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.229/1 prot.

Nr. 1875/1 Prot
Dt. 12.04.22



Shkodër, më 07.04.2022

LËNDA: Mbi vendimin Nr.19, datë 28.03.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 “Për Prefektin” në mbështetje të nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, nenit 27 pika 5, neni 36/1. A, 36/2, nenit 54 shkronja e/1, nenit 55 pikat 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” ndryshuar, Urdhërit të Ministrisë të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet” neni 25/1.a, VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, shtojca nr.47, VKM Nr.1064 datë 22.12.2010 Për disa ndryshime në VKM nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, lidhja nr.II, pika 5/3 dhe 5/6, VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës nr.19 datë 28.03.2022** “Për dhënie në përdorim me afat 9-vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 4.4 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhëse etj..) për ngastrat nr.6 dhe nr.17 ekonomia pyjore Karmë”, sipas dokumentacionit shoqëruar të mbledhjes së datës 28.03.2022 (Nr.1967 Prot datë 4.04.2022)”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore, duke zbatuar ndër të tjera procedurën dhe kërkesat e aktit nënligjor Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shyrimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 2 germa a, pika 7-21 mbi zhvillimin e konkurrimit publik për personat fizikë dhe juridikë që do të marrin pjesë në konkurrim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda

GONI

